



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:300143

Datë: 15.07.2024

Numri i dokumentit: 05940519

PKR.nr.325/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje me gjyqtarët Awni Syla, kryetar i trupit gjykues Alban Ajvazi dhe Sulltane Hoti anëtar të trupit gjykues me zyrtaren ligjore Mervete Krasniqi në çështjen penale kundër të akuzuarit M.R, për shkak të veprës penale, të ri cilësuar Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë më dt. 14.06.2024, në të cilën kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit, Fitore Sadikaj i dëmtuari M.C, i akuzuari M.R me mbrojtësin e tij av. Ahmet Gjinovci sipas detyrës zyrtare, me dt. 14.06.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.07.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari

M.R, i biri i M. dhe e ëma R., e gjinisë B., I lindur me dt. .. në Dr., me vendbanim ne fshatin S., Komuna e D., i pa martuar i gjendjen se dobët ekonomike, me numër personal 1., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 13.12.2017 rreth orës 03.00 në rrugën “Bajram Cakaj”, i pandehuri në bashkëveprim me një person deri me tani të panjohur, në fshatin Komoran, deri sa i dëmtuari M.C ishte duke shkuar në shtëpinë e tij gjatë rrugës dhe me të arritur te shtëpia e vëllait të tij ka vërejtur se diçka ka hy në oborr te shtëpia e vëllait të tij, dhe e ka vërejtur një person me revole në dorë i cili kishte shtënë me revole me qëllim të frikësimit dhe kërcënimit të tij ku predhat kishin goditur objektin garazhen dhe kur i dëmtuari ka filluar të ikë personi tjetër tani i pandehuri M.ka dalë në rrugë, ka përdorur armën e zjarrit e tipit AK-47 e kalibrimit 7.62 mm, me nr. serik 14173545, duke shtënë tri herë në tokë ne drejtim ku ishte duke ikur i dëmtuari me qëllim të frikësimit dhe kërcënimit të dëmtuarit, me ç’rast i dëmtuari kishte arritur qe te largohej nga vendi pa pësuar ndonjë lëndim.

- **Më këtë ka kryer veprën penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të neneve të lartshënuara si dhe neneve 3, 4, 7, 8, 17, 21, 41, 43, 45, 46, 73 të KPRK-ës dhe nenit 358 dhe 364 të KPPRK-ës: të akuzuarin e,

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (2) dy vite si dhe dënim me gjobë në shumën prej pesëqind (500) euro, të cilat dënime i akuzuari do ti mbaj/paguajë, nga dita e plotfuqishmërisë plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 par 3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor shumën prej 100 (njëqind) euro, në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari M.C nga fshati Komoran Komuna Gllogoc për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj Gjykate ka parashtruar aktakuzën me nr. PP/L.nr.40/2019 të datës 30.12.2019, kundër të akuzuarit M.R, për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Për këtë çështje penale gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 03.03.2020, në të cilin seancë pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit, i akuzuari M.C. ka deklaruar se nuk e ndjenë vetën fajtor për veprën penale që i vihet në barrë. Gjkata e ka njoftuar të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij për të drejtat e tij që mund të paraqesin kundërshtimet për provat e cekura në aktakuzë, të paraqesin kërkesë për hudhjen e aktakuzës dhe provave që mbështetet aktakuza, por që të njëjtit brenda afatit ligjor nuk kanë paraqitur kundërshtim.

Mbrojtësi i të pandehurit Av. Ahmet Gjinoci me datë 13.03.2020, i është drejtuar kësaj gjykate me Kërkesë për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, të cilën kërkesë gjykata e ka aprovuar pjesërisht me ç'rast për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, e ka pushuar procedurën penale me

arsyetimin se për këtë vepër penale këtë rast armbajtës i akuzuari është gjykuar me Aktgjykimin e kësaj gjykate PKR.nr.310/2019 të dt.22.01.2020, i cili ka marrë formën e prerë.

Në prani të këtyre rrethanave lidhur me këtë çështje penale gjykata me datë 14.06.2024 ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor vetëm sa i përket pikës I të dispozitivit të aktakuzës ku prezent ishin Prokurorja e shtetit Fitore Sadikaj, i dëmtuari M.C, i akuzuari M.R me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Ahmet Gjinovci, ku është dhënë fjala hyrëse e palëve, është dëgjuar i dëmtuari – dëshmitari M.C. Gjithashtu në këtë çështje penale, është bërë administrimi i provave, është dhënë mbrojtja e të akuzuarit si dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurorja e Shtetit, Fitore Sadikaj në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor lëndë e këtij shqyrtimi ishte aktakuza e të akuzuarit M.R në drejtim të veprës penale vrasje në tentativë në bashkëveprim me personin NN nga neni 178 par 1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor u dëgjuar i dëmtuari dëshmitari M.C. nga deklarata e tij u vërtetua përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale gjithashtu përtej dyshimit të bazuar mirë se i njëjti e ka kryer këtë vepër penale është vërtetuar edhe nga provat e administruara në këtë shqyrtim u dëgjua edhe i pandehuri i njëjti nuk e pranoi kryerjen e veprës penale por i propozojmë gjykatës që mos t'ia falë besimi mbrojtjes së tij dhe i propozojmë gjykatës që i njëjti të shpallet faktor dhe të dënohet sipas ligjit.

I dëmtuari M.C në fjalën përfundimtare deklaroi: E përkrahi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit dhe nuk kam çka të shtoj diçka më tepër.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.R av. Ahmet Gjinovci në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Konsideroj se me provat e administruara në shqyrtimin e sotëm gjyqësor me asnjë provë nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari M.R ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Edhe nga deklarata e të dëmtuarit vërtetohet se nuk kemi të bëjmë me këtë vepër penale nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së. Nga deklarata e të njëjtit - dëmtuarit duke pasur parasysh se personi me revole ka qenë në distancë në largësi 5 deri 6 metra jam i sigurt se sikur të kishte pasur qëllim për të privuar nga jeta sigurisht se së paku do ta plagoste po ashtu duke pasur parasysh deklaratën e të njëjtit kur thotë se personi me kallash armë të gjatë ka qenë në distancë prej 30-50 metra ndërsa ka shkrepur dy predha jam i sigurt se sikur të kishte pasur qëllim që ta privonte nga jeta do ta qëllonte. Konsideroj se pavarësisht se kush ka marrë pjesë në këtë vepër penale nuk kemi të bëjmë fare me tentim vrasje dhe si mbrojtës deklaroj se qëllimi i tyre ka qenë për të vjedhur, andaj i propozoj gjykatës që në mungesë të provave të merr aktgjykimin lirues sepse nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale.

I akuzuari M.R në fjalën përfundimtare deklaroi: E përkrahi fjalën përfundimtare të mbrojtësit dhe nuk kam çka të shtoj diçka më tepër.

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje

dhe përkushtim maksimal profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Pas procedimit të provave materiale dhe dëgjimit të dëmtuarit - dëshmitarit dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëra me tjetrën në kuptim të nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, kjo gjykatë të akuzuarit **M.R** bëri ri cilësimin e veprës penale nga Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, në vepër penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK-së.

Procedura e Provave

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së ka dëgjuar të dëmtuarin në cilësimin e dëshmitarit M.C dhe mbrojtjen e të akuzuarit sikur që bëri administrimin e provave materiale me shkrim si Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt.13.12.2017, Raportimi i ekspertimit me nr. AKF 2019-0057/2019-48 i dt.28.01.2019, dëshmia e lëshuar nga firma Auto Shop Toyota për të pandehurin M.C. si dhe foto albumi i vendit të ngjarjes të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Në dëshminë e tij i dëmtuari dëshmitarë M.C në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 14.06.2024 ka deklaruar, në natën kritike me datë 13.12.2017 në kemi qenë duke luajtur në bilardo në lagje rreth orës 03:00 të mesnatës e kemi përfunduar dhe kemi qenë duke shkuar në shtëpi kemi qenë me A. C. dhe një person tjetër kur kemi shkuar afër shtëpive jemi nda dhe duke shkuar në shtëpinë time ku isha vetëm kam vërejtur diçka që po hyn në oborrin e vëllait dhe kam menduar se është ndonjë qen dhe pasi që nuk e kam vërejt, kur kam shkua ma afër kam vërejt 5 ose 6 metra sa isha ka qenë një person me armë në dorë i cili ka qenë i stacionuar afër shtëpisë së vëllait ka qenë armë pistoletë dhe aty kam insistuar me identifikua kush është nuk kam mundur me vërejt saktë dhe kur kam tentuar edhe më tutje pasi kam shkel në zhavorr është dëgjuar një zhurmë nga këpucët dhe personi që ishte me armë sipas meje ka dëgjuar dhe i njëjti ka kcy dy hapa përpara në drejtim timin dhe ka shtënë me pistoletë dy herë ku më pas personi tjetër ka dal me automatik e kam dëgjuar duke manipuliu - repetit me automatik ka qenë në asfalt edhe pse në ato momente isha duke ikur i njëjti ka shkrep dy herë me armë automatike dhe ka bërëtitur që të ndalem, unë pavarësisht asaj kam ik. Ka shtuar se kur ka shtënë personi me automatik, kam qenë diku 30 deri 50 metra në distancë me të, dhe kam qenë duke tentuar që të hyj përmes një kapigjiku në oborrin e vëllait, e kam godit kapigjikin me krah por skam mundur me hap se ka qenë i mbyllur, kur jam kthye në rrugë më ka dhimb shpina dhe kam menduar se më ka godit predha dhe ashtu s'jam ndal dhe kam shkua te një oborr i një fqinji dhe e kam vërejt se nuk kam lëndime. Ketë person nuk kam mundur me e identifikua, nuk e di arsyen pse ka ardh ky person aty, jam ndie i rrezikuar, ndërsa sipas tij nuk ka qenë qëllimi që te me qëlloi pasi nuk i kam pas borxh asgjë pasi as nuk e kam njohur këtë person, përveç prindin e tij. Në ballafaqimin e bërë nga prokurori në lidhje me deklarinimin e dhëne në prokurori në lidhje me qëllimin e gjuajtjes me arme nga i akuzuari se ka pas mëme vra, i njëjti ka deklaruar se qëndron kjo për faktin se plumbat

kanë ardhur në drejtim timin dhe e kam pa kur tyta e armës ka qit flakë, dhe ato predha e kanë goditur murin ku unë isha i fshehur apo i mbrojtur pas një garazhe dhe distanca e goditjes së predhës në muri dhe meje ka qenë afërsisht 1 metër, ndërsa distanca e personit që ka gjuajtur me revole ka qenë diku 5 metra dhe këto gjuajtje kanë ardhur nga revolja ndërsa predhat e shkrepura nga arma automatike kanë përfunduar në tokë dhe ato predha kanë kaluar nga këmbët e mia e po ashtu personi që ka shtënë ka bërëtitur ndalu. Po ashtu ka shtuar se personi i cili ka shtënë me armë me pasur qellim ka pasur mundësi mëmë vra. Gjithashtu ka shtuar se natën kritike nuk e kam njohur ketë person por me pas e kam kuptua se kush ka qenë, ndërsa prindin e tij e kam njohur në fund i njëjti ka deklaruar se mbetëm ne tërësi pranë gjitha deklarimeve të dhëna më herët.

Gjetjet e gjykatës

Gjykata nga te gjitha provat e lartcekura materiale dhe personale gjeti këto rrethane **jo kontestuese sa i përket të akuzuarit M.R:**

Nuk është kontestuese fakti se natën kritike me datë 13.12.2017 rrethe orës 03:00 pas mesnatës në rrugën “Bajram Cakaj” në fshatin Komoran kishte ndodhur një gjuajtje me armë, ku pjesë e kësaj ngjarje kishte qenë tani i dëmtuari M.C.

Po ashtu ne ketë ngjarje nuk ishte kontestuese se të shtënat e armëve ishin shkrepur nga dy armë të kalibrave të ndryshëm njëra pistoletë dhe tjetra armë automatike AK 47 e kalibrit 7.62 mm me nr. serik 14173545, e cila armë kishte qenë pronë e tani të akuzuarit M.C, e cila armë ishte gjetur – konfiskuar nga policia pas ngjarjes në shtëpinë e tani të akuzuarit, po ashtu një gjendje te tillë u vërtetua edhe me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor.

Po ashtu nuk ishte kontestuese se predhat e shkrepura e te gjetura ne vendin e ngjarjes ishin shkrepur nga arma automatike AK 47 e kalibrit 7.62 mm me nr. serik 14173545, rrethanë e vërtetuar nga Agjencia e Forenzikës së Kosovës pas ekzaminive te bëra e cila armë kishte qenë pronë e tani të akuzuarit M.C,

Për sa i përket faktit që për gjykatën ishte *kontestuese* se i pandehuri M.R ka kryer këtë veprë penale e vërtetuan këto rrethana-fakte:

Kontestuese ishte fakti se i akuzuari të ketë pasur qëllim-dashje për ti privuar nga jeta të dëmtuarin M.C, pasi që duke analizuar dispozitën e veprës penale të vrasjes në tentativë dhe në bashkëkryerje nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, e cila dispozitë shprehimisht parasheh se **“kushdo qe privon personin tjetër nga jeta”** sipas analizës së kësaj dispozite veprimi i kryerjes së kësaj veprë penale konsiston në vrasjen me dashje te personit tjetër, pra kjo veprë ka si pasojë shkaktimin e vdekjes te personit tjetër dhe ky veprim duhet të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekt në mënyrë fizike apo edhe psikike, ndaj të dëmtuarit, pra në rastin konkret duke i analizuar veprimet e të pandehurit M.R nuk manifestohet elementi konstituiv i kësaj veprë penale pasi që i akuzuari me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti të ketë pasur qëllim apo dashje që ta privojë nga jeta të dëmtuarin si element qenësor i veprës penale i njëjti ka shkrepur me armë në drejtim të pjesës së poshtme siç ka deklaruar edhe i dëmtuari ne deklarinimin e tij në shqyrtimin gjyqësor, dhe po ta kishte qëllimin për ta vvarë të dëmtuarin i

kishte të gjitha mundësit për ta bërë një gjë të tillë, pasi që i njëjti ka pasur armën automatike AK 47 ka qenë në një distancë shumë të afërt me të dëmtuarin kur i njëjti ishte duke u kthyer në shtëpi, dhe se në bazë të deklarimit të dëmtuarit në shqyrtimin gjyqësor i njëjti ka theksuar se nuk ka qenë cak i këtij akti pasi që me të akuzuarin as që janë njohur dhe nuk i kishte ndonjë borbh.

Për më tepër nga të gjitha faktet e vërtetuara në shqyrtimin gjyqësor, gjykata erdhi në përfundim se motivi i kësaj ngjarje nuk ka qenë privimi nga jeta i të dëmtuarit por motiv kishte qenë vjedhja në shtëpinë e vëllait të dëmtuarit dhe gjetja në situatë të tillë e të akuzuarit dhe të dëmtuarit ka qenë e rastësishme pasi që siç ka deklaruar edhe vetë i dëmtuari i njëjti kishte qenë në një bilardo në fshatin e tij dhe kishte ndejtur deri në orët e vona dhe duke u kthyer për në shtëpi ishte takuar me të akuzuarin dhe një person tjetër që deri me tani është i paidentifikuar. Te shtënat me armë sipas vërtetimit të gjykatës kanë ndodhur me qëllim të frikësimit dhe kërcënimit të dëmtuarit me qëllim që të njëjtin ta largojnë nga vendi ku e kishin cak për të kryer veprat penale të vjedhjes apo grabitjes me konkretisht shtëpinë e vëllait të tani të dëmtuarit dhe sigurisht edhe mënjanimin e ndonjë sulmi në drejtim të tyre.

Gjykata në prezencën e këtyre provave nuk gjeti asnjë provë e cila e lidh të akuzuarin M.R me veprën penale Vrasje në tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, pasi që nuk janë përmbushë elementet e veprës penale për të cilën i pandehuri akuzohet, mirëpo gjykata gjeti se me veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par 2 të KPRK-së.

Deklarimi i organit të akuzës se është kryer vepra penale e vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, ishte vetëm dyshim i cili nuk ka mbështetje në asnjë provë të besueshme-relevante, pasi që në vrasjen me dashje autori dëshiron që ta vrasë viktimën. Në rastin konkret gjykata në bazë të provave të administruara, **ka vërtetuar se nuk ekzistonin elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së**, pasi që nuk plotësohen elementet inkriminuese si **‘dashja-qëllimi’**, pra për të arritur në përfundim se ku drejtohet dashja e autorit merren parasysh rrethanat subjektive dhe objektive, pra në rastin konkret nisur nga rrethanat e ngjarjes ka rezultuar e provuar se i akuzuari nuk ka pasur qëllim për ta vrarë të dëmtuarin, sepse po të kishte qëllimin për ta vrarë i ka pasur mundësit për ta bërë, sepse i akuzuari ka qenë i armatosur, në momentin kur i dëmtuari ka qenë afër duke u kthyer në shtëpi dhe nuk ka qenë në dioni se në orët e vona pas mesnatës mund të ballafaqohet me dike ketë rast me të akuzuarin dhe po të kishte qenë dashja dhe qëllimi i akuzuarit ka mund që ta privoi nga jeta të dëmtuarin posa të ishte afruar i dëmtuari por sipas gjitha provave dhe deklarimit edhe nga vetë i dëmtuari, i akuzuari me personin tjetër kanë pasur qëllim tjetër që të vjedhin siç u theksua edhe më lartë e jo për të marrë jetën tani të dëmtuarit M.C por qëllimi ka qenë që përmes frikësimit dhe kërcënimit të tij duke e përdorur edhe armën të njëjtin ta largoi nga vendi me qëllim që ta kenë mundësin e largimit nga vendi i ngjarjes pasi që i dëmtuari i kishte vërejtur dhe atë rastësisht duke u kthyer nga një lokal - bilardo që kishin luajtur deri në orët e vona.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e proceduara, faktet dhe rrethanat e vërtetuara, ne shqyrtim gjyqësor, krijon bindjen se i pandehuri M.C nuk ka kryer veprën penale për të cilën ai është akuzuar, mirëpo i njëjti ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par 2 të KPRK-së, ndryshimi i mësipërm sa i përket veprës penale bëhet i domosdoshëm sepse ka rezultuar e provuar se për asnjë moment i pandehuri nuk ka pasur si qëllim vrasjen e të dëmtuarit, andaj ne rastin konkret armën e ka përdor krejtësisht me qëllim të frikësimit dhe kanosjes se të dëmtuarit duke i shkrepur predhat ne drejtim ne pjesën e poshtme siç ka deklaruar edhe vetë i dëmtuari, e që vërtetohet bindshëm se ai po të kishte pasur qëllim për ti vlarë i kishte të gjitha mundësitë për ta bërë një gjë të tillë, pasi e ka pasur afër në momentin kur i dëmtuari kishte qenë duke u kthyer ne shtëpi e ishte has me të akuzuarin. Pra nga kjo vihet në përfundim se me veprimet e kryera nga i akuzuari M.R, ndonëse nuk ka dëshiruar, ka lejuar që tri predha te shkrepura prej armës së tij të godasin në pjesën e poshtme ne tokë, përmes të cilave ka shkaktuar frikë dhe kanosje ndaj të dëmtuarit, dhe mbi këto fakte gjykata bëri rikualifikimin e veprës penale dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në prezencën e këtyre provave nuk gjeti asnjë provë e cila e lidh të pandehurin M.R me veprën penale të Vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, pasi që nuk janë përmbushë elementet e veprës penale për të cilën i pandehuri akuzohet, mirëpo gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit M.R formsohen të gjitha elementet e veprës penale të Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par 2 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoi me shumë kujdes të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, dhe ka ardhur në përfundim se nga dëshmia e dhënë nga ana e të dëmtuarit M.C të dhënë në shqyrtimin gjyqësor u vërtetua se me datë 13.12.2017 i njëjti natën kritike pasi qe kishte qenë ne një lokal - bilardo derisa po u kthente ne shtëpinë e tij ne orët e vona pas mesnate me saktësisht rreth orës 03:00 pas mesnate, dhe posa ishte afruar te shtëpia e vëllait te tij ishte hasur ne të akuzuarin dhe me te kishte qenë edhe një person qe deri me tani është i paidentifikuar, dhe te një njëjtit posa kishin vërejtur te dëmtuarin qe të dy kishin shtënë me armë zjarri personi i paidentifikuar me armën pistoletë ndërsa i akuzuari M.R me armën AK 47 e tipit kallashnikov 7.62 mm, dhe me ketë kishin pasur për qëllim qe ta frikësojnë dhe kërcënojnë te njëjtin pasi qe i dëmtuari siç ka deklaruar edhe ne shqyrtim gjyqësor posa i ka vërejtur ka tentuar qe te shkoj ne drejtim te tyre ne mënyre qe ti identifikoj se kush janë edhe pse fillimisht nuk kishte besuar se mund te jenë njerëz duke dyshuar ne diçka tjetër ndonjë qenë siç është deklarua i dëmtuari. Po ashtu nga dëshmia e të dëmtuarit u vërtetua se mes tij dhe personit te akuzuar nuk kishte pasur ndonjë te keqe e as qe ishin njohur, por se krejtësisht kjo situatë kishte ndodhur duke tentuar te vjedhin ne pronat – shtëpitë e të dëmtuarit dhe familjarëve te tij. Kjo që u theksua me lartë për gjykatën krijon bindjen se për te akuzuarin nuk ishte hera e parë qe ishte involvuar ne kryerjen e veprave penale të ngjashme, pasi që për ketë ekzistojnë të dhëna nga evidenca penale se i njëjti është kryerës i disa veprave penale dhe më parë është gjykuar dhe ka vendime të formës së prerë, rasti ma i fundit ka qenë se ka kryer vepër penale të grabitjes i gjykuar me Aktgjykimin e kësaj gjykate PKR.nr.310/2019 i cili ka marr formën e prerë me datë 23.06.2020, e çka është e rëndësishme te theksohet se ne ketë rast është përdorur arma e njëjtë automatike për të cilën është gjykuar dhe kjo gjykatë ne fazën e kundërshtimit te provave siç u theksua edhe më lartë ne ketë rast e ka pushua procedurën penale për ketë vepër penale, andaj te gjitha këto rrethana dhe prova

tjera të administruara dhe shqyrtuara ne ketë shqyrtim gjyqësor vërtetojnë faktin se i akuzuari ka qenë kryerës i veprës penale për të cilën gjykata e ka shpallur fajtor si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

I akuzuari M.R., në seancën e shqyrtimit gjyqësor te mbajtur me dt.14.06.2024 ndër të tjera deklaroi se: ne lidhje me veprën penale për të cilën akuzohem nuk kam të bëje asgjë me të, ka theksuar se arma e cila është gjetur ne shtëpi ka qenë armë e babagjyshit tim i cili ka ndërruar jetë diku ne vitin 2018 apo 2019. Ka shtuar se ketë armë derisa ka qenë gjallë babagjyshi ai e ke përdorur, ndërsa pas vdekjes se tij unë e kam përdorur për çka edhe e kam vuajtur denimin në një rast tjetër gjyqësor. Me të dëmtuarin asnjëherë nuk kemi pasur ndonjë mosmarrëveshje. Gjithashtu ka theksuar se ketë armë nuk e ka përdorur ne rastin për të cilin ngarkohem, por ka shtuar se ketë armë e kam përdorur ne një rast tjetër të grabitjes, ka shtuar se në familje kam jetuar me babën, vëllezërit, dhe me gjyshin. Në vitin 2017 moshë e vëllezërve ka qenë njëri 10 vjeç dhe tjetër 11 vjeç afërsisht dhe ata nuk kanë pasur mundësi të kenë qasje në armën që ka qenë në dhomë, gjyshi im në atë periudhë ka qenë afërsisht 80 vjeç dhe ka vdekur në vitin 2018, i njëjti ka pasur një shëndet të mirë, babai im punon si zjarrfikës, gjatë vitit 2017 nuk kemi pasur ndonjë vjedhje. Ka shtuar se nuk kam qenë pjesë e asaj ngjarje për të cilën ngarkohem, nuk më kujtohet se ku kam qenë nuk e di a kam qenë në Kosovë, ka theksuar se me të dëmtuarin jemi diku afërsisht 5-6 kilometra larg me shtëpi edhe pse te njëjtin nuk e kam njohur.

Sa i përket mbrojtjes se të akuzuarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor gjykata të njëjtit nuk ja fali besimin, pasi që i njëjti me qëllim të ikjes se përgjegjësisë, mohon të ketë qenë pjesë e kësaj ngjarje, duke deklaruar se nuk e di a kam qenë ne Kosovë apo jo ne atë periudhë, po ashtu i njëjti ka mohuar se ta ketë përdorur armën automatike AK 47, ndërsa në anën tjetër tri predhat që janë shkrepur ne vendin e ngjarjes ku është përdorur kjo armë është vërtetuar nga ekspertiza se janë shkrepur nga kjo armë përkatësisht arma AK 47 e kalibrit 7.62 mm me nr. serik 14173545, për të cilën armë edhe është dënur i akuzuari gjë për të cilën edhe vetë e ka pohuar se për ketë e kam vuajtur edhe denimin. Gjithashtu e njëjta armë deri në momentin e sekuestrimit nga ana e policisë ketë armë e kanë pasur ne posedim dhe mbikëqyrje vetë familja e tij përkatësisht i akuzuari dhe nuk ka pasur mundësi ta përdor dikush tjetër ketë armë përveç këtij të akuzuarit moshë e vëllezërve të tij siç u theksua ne atë periudhë kanë qenë njëri 10 e tjetri 11 vjeç. Andaj nga këto arsye gjykata deklarimit të tij nuk ja fali besimin pasi që ky deklaram nuk ishte i sigurtë dhe nuk ndërlihet as me provat e administruara ne shqyrtimin gjyqësor.

Nga Raporti i Ekspertimit me shenjen 2018-AG-0842 të dt 29.01.2019, i përpiluar nga Ekspertet e balistikës Lutfi Raci dhe Qendrim Topalli është vërtetuar se: pas ekspertizës lidhur me armën e cila ka qenë objekt i ekspertimit ka rezultuar ndër tjera se dy gëzhojat e kalibrit të njëjtë 7.62.39mm të ruajtura në librin e rasteve të hapura me nr. të referencës C-2439A, me numër të hetimeve 2017-AG-0848, lidhur me veprën penale vrasje ne tentativë me numër 2018-AG-0842, dhe numër të balistikës B18-0809, te ekzaminuara më herët me datë 11.10.2018dhe gëzhojat e kalibrit 7.62.39mm, dëshmitë e evidentuara me shifra VN=1 dhe VN=2, janë të ruajtura në librarinë e rasteve të hapura me numër referues C-2500me numër te hetimeve 2018-AE-1444, vepra penale Grabitje te ekzaminuara me dt. 28.01.2019. nga kjo vërtetohet se për ketë armë nga ekzaminimet e bëra për dy raste penale del se e njëjta armë është përdorur ne kryerjen e veprave

penale dhe atë njëra qe ndërlidhet me këtë rast dhe tjetra e kryer në vitin 2019, dhe përmes kësaj vërtetohet se i akuzuari ka qenë pjesë e kësaj vepre penale dhe veprat penale i ka kryer me te njëjtën armë.

Nga dëshmitë e dy fletave të lëshuara nga Kompania “Auto Shop Toyota”, e në të cilat janë shënuar ditët e pushimit kur ka marr tani i akuzuari M.dhe nga kjo kemi vërtetuar se i njëjti me dt. 13.12.2017 dhe 16.12.2017 ka qenë në pushim, e që data 13.12.2017 ndërlidhet me rastin që është vërtetuar nga gjykata se ka kryer veprën penale për te cilën është shpallur fajtor.

Nga fotografitë te cilat janë pjesë e shkresave të lëndës e të cilat gjykata i ka administruar si provë shihet qartë objekti ku kanë goditur predhat e shkrepura me armët pistoletë dhe arma automatike AK47, vendi ku kanë goditur etj..

Gjykata bazuar ne gjendjen faktike te vërtetuar, ne këtë çështje penale gjeti se ne veprimet inkriminuse te të akuzuarit manifestohen te gjitha elementet qenësore si ato objektiveve edhe ato subjektive te veprës penale. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par 2 të KPRK-së.

Vepra penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par 2 të KPRK-së, përcakton se: Kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Gjykata gjithashtu duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për matjen dhe ashpërsimin e dënimit, ka gjetur; **shkallën e lartë të dashjes**; pasi që i akuzuari me vetëdije të plotë ka dashtë që të kryhet kjo vepër penale **rrethanat në të cilat është kryer kjo vepër penale**, pasi që i njëjti ka përdorur armën e tij me qëllim që të dëmtuarit ti shkaktoj frikë dhe ta kërcënoi, **intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur**, siç rezulton me veprimet e të akuzuarit janë rrezikuar vlerat themelore te mbrojtura të individëve në rastit konkret ka mundur të shkaktohen pasoja edhe me të mëdha në rastin konkret ndaj tani të dëmtuarit.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme lidhur me matjen dënimit si rrethana lehtësuese, për të akuzuarin ka gjetur; se i njëjti ka qenë korrekt me gjykatën dhe palët në procedurë, ndërsa si rrethana rënduese të akuzuarit gjykata i mori faktin se i njëjti është person recidivist kryerës i veprave penale te kryera me parë dhe i dënuar me aktgjykim te kësaj gjykate me numër PKR.nr.310/2019 i cili ka marr formën e prerë me datë 23.06.2020.

Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me këtë dënim, është e bindur se do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së, dhe atë duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, duke qenë i bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës individuale, që ta parandaloi të pandehurin

nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës gjenerale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor është marrë në pajtim me nenin 449 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për shumën e të hollave në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë në pajtim me nenin 36 par.3, nënpar.3.2 të Ligjit nr. 0//L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.325/2019 të dt. 15.07.2024

Zyrtare Ligjore
Mervete Krasniqi

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Avni Syla

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 30 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.